



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Shkup, 1 nëntor 2012

**Ceremoni për ndarjen e Çmimit për ndërmarrjet që zbatojnë
përgjegjësi shoqërore
2011**

(Hotel Holiday Inn)

**Fjalim i
Shkëlqesia e tij, z. Aivo Orav
Shef i Delegacionit të BE-së**

I nderuar Ministër z. Krlev,

I nderuar z. Nikolov,

Zonja dhe zotëri,

Dua ti falënderohem organizatorëve që më kanë ftuar sot të ju adresohem shkurtimisht me rastin e ceremonisë për ndarjen e Çmimit nacional për ndërmarrjet me përgjegjësi sociale 2011.

Përgjegjësia sociale e ndërmarrjeve konsiderohet si një nga vlerat themelore të sistemit të ri ekonomik dhe social të Bashkimit Evropian. Ky koncept, me anë të së cilit kompanitë në baza vullnetare integrojnë përcaktime sociale dhe mjedisore në veprimtarinë e tyre, mund të ndihmojnë në koordinimin e ambicieve ekonomike, sociale dhe mjedisore të BE-së.

Përparim i madh është arritur në këtë çështje pas apelimit nga Këshilli i Lisbonës në mars të vitit 2000 deri tek kompanitë për kuptimin e tyre lidhur me përgjegjësinë sociale. Sot, parimi i përgjegjësisë sociale të ndërmarrjeve është plotësisht i përfshirë në Strategjinë evropiane 2020 për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe inkluzive të integruar në politikat e shumta të BE-së, duke i përfshirë edhe: politikat sociale dhe politikat për punësim, politikat industriale dhe sipërmarrëse, politikat për

mjedisin, mbrojtjen e konsumatorëve, rregullat dhe procedurat për prokurimet publike dhe marrëdhëniet e jashtme.

Ndërmarrjet, si motor për rritje ekonomike, për krijimin e vendeve të reja të punës dhe inovacione janë faktorët kryesor për realizimin e synimeve të Lisbonës për zhvillim të qëndrueshëm.

Është më se e qartë se në ekonominë e tregut, bizneset duhet të arrin fitim. Megjithatë, qëndrimi unik evropian konsideron se për arritjen e këtij synimi në mënyrë të qëndrueshme, aktivitetet e tyre ekonomike duhet në fund tu shërbejnë interesave shoqërore.

Ndërmarrjet e bëjnë këtë përmes pasurisë që e prodhojnë, vendet e punës që i krijojnë, shërbimet dhe mallrat që i ofrojnë, dhe në të njëjtën kohë, duke u kujdesur për mjedisin dhe komunitetet lokale ku ata funksionojnë.

Në Bashkimin Evropian, numri i bizneseve që veprojnë në bazë të përgjegjësisë sociale, duke miratuar dhe zbatuar kode të tyre për sjellje dhe punë në bashkëpunim me aktorët të ndryshëm për të forcuar përgjegjësinë sociale të ndërmarrjeve është vazhdimisht në rritje.

Numri i kompanive të tilla është në rritje por jo si rezultat të obligimeve juridike, por për arsye të vullnetit aktual të bizneseve

për tu përgjigjur pritjeve të shoqërisë, që të veprojnë përtej ligjit dhe të kontribuojnë për zhvillimin e qëndrueshëm.

BE-ja e përkrah këtë eveniment pasi që konsideron se opinioni publik duhet ti njeh dhe ti shpërblej përpjekjet e kompanive të caktuara jo vetëm për fitimin e tyre por edhe për kontributin e drejtë në lidhje me adresimin e sfidave të caktuara shoqërore.

Në fund, i përshëndes të gjithë fituesit e Çmimit nacional për përgjegjësi sociale të ndërmarrjeve dhe besoj se shembulli pozitiv do ti inspiroj kompanitë tjera lokale të fillojnë iniciativa të reja inovuese.

Ju faleminderit shumë për vëmendjen tuaj.